

Rregullore “Back to school”

Shoqëria Qendra Tregtare Univers sh.p.k. kërkon t’ju parashtrojë projektin për shorteun e “Back to school” në QTU nëpërmjet të cilit kjo qendër fton dhe informon klientët e saj të marrin pjesë në këtë lojë promovionale që do të zhvillohet në datat 4 shtator-27 shtator pranë Qendrës Tregtare QTU me vendodhje në Autostradën Tiranë-Durrës, kilometri i shtatë, Kashar, Tiranë.

Kjo lojë promovionale do të ketë një shtrirje kohore prej 27 ditësh, ku pjesëmarrësit do të fitojnë 10 cmime.

Si me poshtë rregullorja:

Vendodhja: Qendra Tregtare Univers, (“QTU”);
Periudha: 4 shtator-27 shtator 2020
Pranueshmëria: *Shorteu është i hapur për të gjithë vizitorët e QTU mbi 18 vjeç. Shorteu nuk është i hapur për punonjësit dhe përfaqësuesit e Dyqaneve apo stafi promovional, punonjësit dhe përfaqësuesit e QTU.*

Duke marrë pjesë në këtë lojë promovionale, të gjithë pranojnë termat dhe kushtet e rregullave të mëposhtme të Shorteut dhe pranojnë t’u përmbahen atyre:

Shoqëria Qendra Tregtare Univers Sh.p.k. (Shoqëria) dëshiron të organizojë një lojë promovionale Shorteu “Back to school” me të dhënat e mëposhtme:

1. Për të marrë pjesë në Shorte, pjesëmarrësit duhet të shkruajnë të dhënat e tyre personale (Emer Mbiemer, Nr telefoni) në pjesën e pasme të kuponit me të cilin kanë kryer blerje në një nga dyqanet e QTU me një vlerë minimale prej 1.000 LEK (një mijë leke).
2. Për të hedhur kuponin me të dhënat tuaja në këtë shorte duhet të vizitoni QTU dhe të gjeni “ekspozitorin” e vendosur në një vend të rastit në hapësirat e Qendrës Tregtare.
3. Në shorte do të jepet 10 cmime si në tabelën e mëposhtme:

Pershkrimi	Cmimi me TVSH	Cmimi pa TVSH
1. Cmimi I parë- MacBook Air 13"mqd32ze/a	129,990	108,325
2. Cmimi I dytë- PC Asus V222 UAK dhe Printer HP F5S40B DeskJet	55,480	46,233
3. Cmimi I tretë- PC Asus V222UAK	49,990	41,658

4. Cmimi I katërt- Ipad mini 5& Cover	67,990	56,658
5. Cmimi I pestë- Ipad mini 5	62,990	52,492
6. Cmimi I gjashtë -Printer HP F5S40B DeskJet	5,490	4,575
7. Cmimi I shtate – Ora per femije Connected watch	6,250	5,208
8. Cmimi I tete – Ora per femije Connected watch	6,250	5,208
9. Cmimi I nente – Ora per femije Connected watch	6,250	5,208
10. Cmimi I dhjetë- Kufje Sony on Air MDR-ZX110	1,990	1,658

4. Çdo përpjekje e dyshuar për të manipuluar rregullat e shorteut me kupona te pavlefshem apo te subjekteve qe ndodhen jashte Qendres Tregtare Univers do të konsiderohet totalisht si e pavlefshme.
5. Shorteu dhe shpallja e numrit fitues do të zhvillohet në praninë e një noteri, një përfaqësuesi të Autoritetit të Mbikeqyrjes së Lojrave të Fatit pranë Ministrise së Financave, përfaqësuesve të Degës Rajonale të Njesise se Tatimpaguesve te Medhenj Tiranë te cilet do te njoftohen nga QTU sipas kerkesave te VKM Nr.196 date 15.03.2017 si edhe ne prani të Komisionit te Lojes se Fatit Promocionale të ngritur me këtë rast nga ana e QTU.
6. Hedhja e shorteut dhe shpallja e kuponit fitues do të zhvillohet drejtperdrejt ne emisionin “E diela Shqiptare” ne studiot e Televizionit kombetare Klan, pergjate programacionit te emisionit. Perzgjedhja e fituesve do te behet manualisht duke terhequr kuponat tatimor ne kutine perkatese nga nje anetar i jurise, moderatori apo pjestare te tjere te show te perzgjedhur nga moderatori dhe do te jene 10 (dhjete) fitues. Personat, kuponi I te cileve do te perzgjidhen ne studion e emisionit ne daten 27 Shtator duhet qe te pergjigjen patjeter ne telefon kur moderatori i emisionit ta telefonoje. Ne rastin se personi i perzgjedhur nuk i pergjigjet telefonates verifikuese si dhe thirrjes verbale te moderatorit, atëhere do te merret automatikisht e mireqene se ky person nuk eshte i disponueshem, per kete arsye ky person do te skualifikohet dhe cmimi do t’i kaloje nje kuponi tjetër. Nëse edhe fituesi i rradhes nuk pergjigjet ne telefonaten qe do te realizoje moderatori atehere perzgjedhja e kuponave fitues do te vijoje deri ne shpalljen e fituesit qe do te pergjigjet ne telefon ne momentin e prononcimit te emrit te tij nga moderatori.

7. Perjashtim nga detyrimi per t'u pergjigjur ne telefon gjate momentit te perzgjedhjes sipas pikes 6 me sipër, bejne vetem personat, te cilet nuk mund te pergjigjen ne momentin e kryerjes se telefonates per arsye te ndonje fatkeqesie natyrore apo ndonje force madhore. Ne rast se keta persona provojne me dokumente te verifikueshme zyrtarisht se ndodhen perpara nje rasti fatkeqesie apo force madhore, ata do te kene te drejte te vijne te terheqin cmimin prane Qendres. Nese nuk mund t'i pergjigjen telefonates ne momentin e perzgjedhjes per shkak te rasteve te mesiperme te verifikueshme, ata mund te drejtohen tek QTU/Organizatori i Shorteut per te terhequr cmimin e fituar por pasi QTU te kete pranuar si te vlefshme dokumentet qe provojne forcen madhore apo fatkeqesine e ndodhur. Per qellim te kesaj dispozite me fatkeqesi natyrore dhe force madhore do te nenkuptojme: aksidente, greva, kryengritje, rebelime, akte terroriste, shkaqe natyrore si stuhi, tërmete, vullkane, fatkeqesi personale si aksidente apo vdekje te afermeve, përmbytje dhe forca të tjera të natyrës që nuk mund të parashikohen objektivisht nga personat dhe qe mund te pengojne keta te fundit t'i pergjigjen telefonates gjate momentit te perzgjedhjes.
8. Organizatori i Shorteut rezervon të drejtën për të verifikuar nëse fituesi i lojes plotëson të gjitha kriteret për pranueshmëri në Shorte. Vendimet e Organizatorit të Shorteut janë përfundimtare dhe nuk mund të pranohen ankesa për çështjet që lidhen me dhënien e çmimeve.
9. Shanset për të fituar do të jenë totalisht të rastësishme dhe në praninë drejtperdrejt ne valet e televizionit Klan. Të gjitha shënimet ne kuponin e perzgjedhur, që janë jo të plota, të palexueshme, të dëmtuara, të parregullt, të cilat janë dorëzuar me anë të mjeteve të paligjshme, ose që nuk përputhen me kushtet e Rregullores për Shorteun (*përfshirë këtu të gjithë kuponat qe verifikohet se nuk jane te dyqaneve te QTU dhe nuk jane brenda afatit te fushates, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 7 më sipër*) mund të skualifikohen nga Organizatori i Shorteut. Organizatori i Shorteut nuk mban asnjë përgjegjësi për kuponat e humbur , të vonuara, të dëmtuara. Të gjitha shënimet bëhen pronë e Organizatorit të Shorteut dhe nuk do të kthehen.
10. Numri i pjesemarrësve ne shorte eshte parashikuar te jete gjithsej eshte 20.000.
11. Duke marre pjese në këtë Shorte dhe duke plotesuar te dhenat e tyre personale ne pjesen e pasme te kuponit, pjesëmarrësit autorizojne Organizatorin per perdorimin e te dhenave te tyre personale, dhe japin miratimin e tyre për përdorimin e të dhënave vetëm për qëllimin specifik të pjesëmarrjes në këtë Shorte.
12. Organizatori i lojes promociionale mbledh të dhëna personale për pjesëmarrësit, **vetëm** me qëllim administrimin e këtij Shorteu.
13. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me lojën promociionale (duke përfshirë, pa kufizim, edhe mosmarrëveshje kur Pjesëmarrësi ka vepruar në përputhje me të gjitha rregullat dhe rregulloret Zyrtare) do të zgjidhet nga Oganizatori i lojës promociionale vetëm në diskrecionin e tij absolut. Të gjitha vendimet e Organizatorit të lojes promociionale do të jenë përfundimtare.

14. Ky Shorte do të organizohet në përputhje me këto Rregulla. Pjesëmarrësi duhet të jetë në përputhje me këto Rregulla, dhe do të konsiderohet se ka pranuar dhe kuptuar Rregullat e pjesëmarrjes në lojë. Kushtet e kësaj loje promovionale , siç është përcaktuar në këto rregulla, nuk janë subjekt i ndryshimit ose kundërshtimit nga pjesëmarrësi në shorte.